



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë: 28.05.2013
Nr. 0204-678

PËR: Isa Mustafa, Kryetar i Komunës së Prishtinës
Sami Hamiti, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Prishtinës

LËNDA: KONFIRMIM I LIGJSHMËRISË SË VENDIMIT TË KOMUNËS SË PRISHTINËS, 01Nr.031-74905, Pranuar me datë, 23.05.2013.

Të nderuar/a

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare 02/2011 për Fushat dhe përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit Ministrive, pas shqyrtimit të Vendimit 01.Nr.031-74905, të miratuar me datë 16.05.2013, **KONFIRMON** ligjshmërinë e këtij akti dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale .

Akti juridik i listuar si në vijim, ka efekt të plotë juridik.

- Vendimi 01.Nr.031-74905, për diskutim publik të projektplanit zhvillimor komunal për periudhën 2013-2022.

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i MAPL-së,

Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm i MAPL -së
Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së
Arkivit të MAPL-së.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datum: 28.05.2013
br. 0204-678

Za: Isa Mustafa, Gradonačelnik opštine Priština
Sami Hamiti, Predsedavajući Skupštine opštine Priština

Predmet: Potvrda zakonitosti odluke opštine Priština , 01br.031-74905, Primijeno dana , 23.05.2013.

Poštovani/e

Ministarstvo administracije lokalne samouprave u skladu sa njenim mandatom, definisano zakonom o lokalnoj samoupravi br. 03/z-04, dodatak XII uredbe Vlade 02/2011 o odgovornim administrativnim oblastima kancelarije Premijera i Ministarstva nakon razmatranja odluke 01.br.031-74905, odobreno dana 16.05.2013, POTVRĐUJE zakonitost ovog akta i procenjuje da je isti taj u potpunom skladu sa zakonom o lokalnoj samoupravi .

Pravni akt sa potpunim pravnim dejstvom je , kao što sledi,

Odluka 01.br.031-74905, o javnoj raspravi opštinskog razvojnog nacrt plana za period 2013-2022.

Sa poštovanjem,

Slobodan Petrović,
Zamenik premijera i Ministar MALS-a,

Kopije: Besnik Osmani, Generalni sekretar MALS-a
Rukovodiocima odeljenja MALS-a
Arhivi MALS-a.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d dhe nenit 17, pika b të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28/15, qershor 2008), të dispozitave të nenit 13 të Ligjit nr 2003/14, për planifikimin hapësinor dhe nenit 9 të Ligjit nr. 03/L - 106, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/14, për planifikim hapësinor dhe të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 16.05.2013, miratoi këtë

VENDIM ✓ ok
**PËR MIRATIMIN DHE LËNIEN NË DISPOZICION PËR DISKUTIM PUBLIK TË
PROJEKTPLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL PËR PERIUDHËN 2013 - 2022**

I.

Miratohet Vendimi për miratimin dhe lënien në dispozicion për diskutim publik të Projektplanit zhvillimor komunal për periudhën 2013 - 2022.

II.

Propozimplani i cekur në pikën I të këtij Vendimi, përbëhet nga pjesa tekstuale dhe grafike.

III.

1. Pjesa tekstuale e Planit përmban: profilin e zhvillimit hapësinor dhe analizën e gjendjes, vizionin, parimet dhe caqet, komizën e zhvillimit hapësinor, strategjitë dhe dispozitat për zbatim.
2. Pjesa grafike e Planit përmban të dhënat hartografike dhe pjesët tjera grafike, ku përshkruhet gjendja në hapësirë dhe ndërhyrjet në të.
3. Prezantimet hartografike të digjitalizuar të Planit paraqesin tërësinë e zgjidhjeve të planifikuara.

IV.

1. Në pjesën tekstuale të Planit paraqitet profili i gjendjes në komunën e Prishtinës, pozita, rëndësia dhe çështjet tjera specifike të territorit të komunës së Prishtinës, në kontekst me Planin hapësinor të Kosovës, analizën e profilit me të cilën tregohen përparësitë, mangësitë dhe mundësitë e zhvillimit të komunës së Prishtinës, si dhe vlerësimet e ndikimit socio-ekonomik dhe mjedisor në këto zhvillime.

Faqe 1 nga 2

2. Përmbajtja e vizionit dhe parimeve paraqet të ardhmen e komunës së Prishtinës, caqet dhe prioritetet strategjike zhvillimore afatgjate.
3. Korniza e zhvillimit hapësinor komunal përmban strukturën dhe lokacionin hapësinor për zhvillimin dhe organizimin e ardhshëm ekonomik: regjenerimit, turizmit, rekreacionit, tregtisë, transportit komunal, popullsisë, banimit, vendbanimeve, çështjeve sociale, trashëgimisë kulturore, mjedisit, duke përfshirë trashëgiminë natyrore, shënimin e zonës urbane ekzistuese dhe zgjerimet e propozuara për të ardhmen, si dhe ndërtimin jashtë zonës urbane dhe zonave ndërtimore të fshatrave.
4. Pjesa e zbatimit të Planit përbën, kushtet e rëndësishme për zhvillimin dhe shfrytëzimin e tokës në komunë, destinimin e sipërfaqeve, zonat ndërtimore për vendbanime dhe strukturat ekzistuese jashtë zonave të vendbanimeve, kushtet për vendosjen e korridoreve apo traseve dhe sistemeve të tjera të infrastrukturës dhe masat për parandalimin e ndikimeve negative në mjedis.

V.

Propozimplanin i cekur në pikën I të këtij Vendimi, iu lihet në dispozicion për shqyrtim dhe vlerësim publikut, agjencive, drejtorive dhe subjekteve të tjera.

VI.

Afati për shqyrtimin e propozimplanit të zhvillimit të komunës, të cekur në pikën I të këtij vendimi, është 60 ditë.

VII.

Teksti final, para miratimit në Kuvendin e Komunës, i dërgohet për pëlqim Ministrisë së Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor, për t'u verifikuar përputhshmëria e tij me planin hapësinor të Kosovës.


VIII.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe Zyra për marrëdhënie me publikun e Kabinetit të Kryetarit.

IX.

Ky vendim hyn në fuqi tetë (8) ditë nga dita e publikimit të tij në tabelën e shpalljeve të Komunës dhe në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01. nr. 031 - 74905, më 21.05.2013



Faqe 2 nga 2

Adresa: Rr. UÇK-2-10-000 Prishtinë-Kosovë
Telefon: +381(0)38/230-900
<http://www.prishtina-komuna.org>